

KLSH merr pjesë në takimin e shtatë të Task Forcës së Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore të EUROSAT-t

Kontrolli i Lartë i Shtetit në cilësinë e anëtarit mori pjesë në datat 19-20 tetor 2023 në takimin e shtatë të Task Forcës së Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore të EUROSAT dhe seminarin me temë “Shpërndarja e transfertave dhe granteve” që u zhvillua në Varshavë, Poloni. Ky takim u zhvillua nën drejtimin e Institucioneve Supreme të Auditimit të Polonisë dhe Lituanisë.



Nën moderimin e ekspertëve polakë dhe lituanëzë, u prezantuan nga përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse eksperiencat dhe sfidat e hasura gjatë auditimeve në lidhje me kontrollin e brendshëm të granteve, kriteret e shpërndarjes së transfertave buxhetore për njësitë e qeverisjes vendore, përmirësimi metodologjik i auditimit të tyre, auditimi i borxhit të njësive të qeverisjes vendore, etj.

Një nga arritjet e paraqitura në takim ishte edhe prezantimi nga Institucioni Suprem i Auditimit i Maqedonisë së Veriut i rezultateve të auditimit të përbashkët të zhvilluar nga anëtarët e EUROSAT-t, pjesë e të cilit ishte edhe KLSH, me temë “Përdorimi i të ardhurave të veta të njësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve cilësore gjatë pandemisë”. Rezultatet e prezantuara paraqitën ndërmjet pjesëmarrësve kontributin dhe vlerën e shtuar nga shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet institucioneve supreme të auditimit në rastet e sfidave të përbashkëta dhe domosdoshmërinë e zhvillimit të bashkëpunimit të mëtejshëm në kryerjen e auditimeve të përbashkëta.

Në përfundim, u bë miratimi i kalimit të statusit të koordinatorit/sekretarit nga Institucioni Suprem i Auditimit të Lituanisë në atë të Letonisë dhe u dakortësua zhvillimi i takimit të ardhshëm të Task Forcës në Tbilisi, Gjeorgji me ftesën e Institucionit Suprem të Auditimit të Gjeorgjisë. Në të njëjtën kohë u zhvilluan diskutime për strategjinë e task forcës për periudhën 2024-2027, aktivitetet e planifikimit për vitin 2024 dhe temën e propozuar në vijim për auditimin e projekteve të infrastrukturës publike në njësitë e qeverisjes vendore.



Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga audituesit z. Artan Guzi, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore, z. Adhurim Banushaj auditues pranë Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, si dhe z. Rigels Guzi, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit.